



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201901564/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2019

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të paraburgosurve në I.E.V.P. Tropojë*

**Drejtuar:** **Z. Agim Ismaili**  
Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve

**TIRANË**

**Znj. Flutura VATOCI**  
Drejtore i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale  
(I.E.V.P.) Tropojë

**TROPOJË**

**Të nderuar zotërinj!**

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues<sup>1</sup>, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) Tropojë me datë 23.07.2019, sipas një plani inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin Alfred Koçobashi, Besnik Deda dhe Genci Tërpo, me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishte vlerësimi i kushteve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) Tropojë, cilësia e trajtimit të të paraburgosurve në të, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të parashtruara pas inspektimit të realizuar në vitin 2018, dërguar me shkresën tonë me nr. K4/I52-2 datë 25.01.2019.

Vizita u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi me të gjithë personat dhe ambientet që duhet të monitoronin.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

<sup>1</sup> Në mbështetje të nenit 19/1 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

## Shënime paraprake

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) Tropojë për vitin 2019. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale ( I.E.V.P.) Tropojë është kategorizuar si institucion i sigurisë së zakonshme me regjim paraburgimi dhe burgimi, përkatësisht me kapacitet 10 dhe 16 persona.

Ndarja midis dy sektorëve që ndodhen në të njëjtin korridor, kryhej me anë të një skare. Në ditën e vizitës inspektuese në institucion trajtoheshin 6 të paraburgosur dhe 13 të dënuar, duke patur një numër brenda të kapacitetit zyrtar të këtij institucionit të parashikuar në 26 persona.

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, Grupi i punës u takua fillimisht me drejtuesen e institucionit Znj. Flutura Vatoci, e cila u shpreh e gatshme për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit.

Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të parashtruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit pas inspektimit të vitit 2018.

Lidhur me rekomandimin tonë është mbajtur një qëndrim zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën me nr.2320/1 prot. datë 25.04.2019.

Nga biseda paraprake si dhe nga inspektimi në vend u konstatua se rekomandimet e bëra pas inspektimit të vitit 2018, kishin gjetur zbatim:

- Në godinën e I.E.V.P. Tropojë ishin kryer investime të reja të pjesshme. Për rrjedhojë kishte përmirësime të ndjeshme në ambientet e pritjes dhe takimit të të dënuarve/paraburgosurve me familjarët.
- Ishin në ndërtim e sipër zgjerimi i fushës së kalçetos i cili do të shërbejë si ambient i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve sportive, rekreative dhe zgjerim i ambienteve të ajrimit. Ndërkohë që u konstatuan ndryshime pozitive strukturore pasi me shpenzime të vogla të brëndshme dhe me punë vullnetare ishte realizuar hidroizolimi i ndërtesës.
- U konstatua se kishte gjetur zgjidhje problematika e mbajtjes në ambientet e institucionit të personave të ndaluar/arrestuar në pritje të caktimit të masës së sigurimit, në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 2151 prot. datë 17.03.2015 dhe nr. 1054/1 prot. datë 16.03.2015, të lidhur midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, *“Për rritjen e sigurisë në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sigurimin e të burgosurve dhe të dënuarve që trajtohen me leje, respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale”*. Nga ana e I.E.V.P. Tropojë i ishte kërkuar D.P.B.-së rishikimi i kësaj marrëveshje sikurse provohej dhe me shkresën me nr. 783 prot. datë 20.07.2017, në mënyrë që personat e ndaluar/arrestuar deri në momentin e caktimit të masës së sigurimit të transportoheshin dhe mbaheshin në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës.
- U konstatuan të njëjtat probleme për sa i përket plotësimit të nevojave për blerje të artikujve të ndryshëm nga ana e të paraburgosurve dhe të dënuarve. Kjo pasi me urdhër të

D.P.B.-së është ndaluar funksionimi i blerjeve më arkat e institucioneve dhe këto janë zevendësuar me pajisjen e të dënuarve me karta debiti nga filialët e bankës BKT por në rrethin e Tropojës nuk ka filial të bankës BKT për të mundësuar pajisjen e personave me karta, Urdhëri i D.P.B. nr. 4629/1 prot. datë 11.07.2012 “*Mbi pajisjen me karta debiti të të dënuarve në I.E.V.P.*”, dhe urdhëri nr. 2399 prot. datë 01.04.2013 “*Mbi përdorimin e arkës së të dënuarve dhe kartat e debitit për të dënuarit*”, vazhdojnë dhe nuk gjejnë zbatim.

## **1. Trajtimi**

Gjatë vizitës monitoruese grupi i ekspertëve vizitoi dhe kontaktoi me të dënuarit/paraburgosurit në të gjitha ambientet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) Tropojë, duke patur në vëmendje mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në I.E.V.P, si dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, të dhunës fizike, apo të ushtrimit të forcës tej kufijve të parashikuar nga aktet normative në fuqi.

Nga bisedat e realizuara me të paraburgosurit dhe të dënuarit, në dhoma e më vete, pa praninë e punonjësve të insitucionit, nuk rezultoi që ndaj tyre të ishte ushtruar dhunë fizike apo psikologjike. Po ashtu, nga verifikimi i dokumentacioneve rezultoi se prej një periudhe të gjatë nuk kishte situata të përdorimit të masave disiplinore ndaj të paraburgosurve falë marrëdhënieve pozitive të ndërtuara ndërmjet të paraburgosurve, si edhe midis tyre e stafit të institucionit.

Të paraburgosurit u shprehën të kënaqur me shërbimin shëndetësor si dhe me mënyrën me të cilën trajtoheshin kërkesat dhe ankesat e tyre nga stafi.

Po ashtu, thuajse të gjithë të paraburgosurit u shprehën të kënaqur në lidhje me ushqimin e servirur në institucion.

Takimet, telefonatat dhe shërbimet e tjera ofroheshin në mënyrë të drejtë për të gjithë. Kur prej të paraburgosurve kërkoheshin takime shitesë me familjarët, ato rezultojnë të mundësuar në çdo rast. Takimet zhvilloheshin në rregull sipas planifikimeve në një ambient me dy poste, pa kufizime, të pajisur me një tavolinë dhe disa karrige në kushte të mira.

Të dënuarit dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit.

Ankesa të tjera kishte mbi mundësimin e blerjeve. Në kushtet kur në institucion nuk lejohej më njësia tregtare dhe kur arka nuk ishte në funksion, të paraburgosurit dhe të dënuarit e kishin të vështirë të mbulonin nevojat e tyre për blerje nëse nuk kishin mbështetjen familjare apo të të bashkëvuajtësve të tjerë. Veçanërisht pamundësia e blerjeve ndikonte në shtetasit e huaj dhe ata të braktisur nga familja.

Pothuajse të gjithë të dënuarit e konsumonin ushqimin në institucion dhe pohuan se ishte i kënaqshëm për nga cilësia, por problem ishte larmia.

Punësimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve në I.E.V.P. Tropojë bëhej në përputhje me Urdhrin e D.P.B.-së nr. 2916, dt. 18.04.2016. Në ditën e inspektimit rezultoi disa të punësuar në pozicionet sanitare, berber, punonjës biblioteke, mirëmbajtës, lulishtar dhe shpërndarës ushqimi.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit, u shprehën të kënaqur nga gatishmëria e stafit mjekësor në përgjigje të kërkesave për ndihmë mjekësore si në rastet e urgjencës, ashtu dhe në përmbushjen e kërkesave për konsulta të specializuara.

## **2. Masat mbrojtëse.**

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Ankesë/kërkesat, në mungesë të kutisë i dorëzoheshin specialistit të sektorit psiko-social të hapura dhe seleksionoheshin në drejtori për të përcaktuar destinacionin e tyre. Tek regjistri përkatës u konstatua se kishte vetëm kërkesa.

Komisioni i pritjes funksiononte në rregull. Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte mbulim të mjaftueshëm me kamera, të cilat funksiononin në rregull pa ndërprerje. Të dënuarve dhe të paraburgosurve u ishin siguruar kushte të përshtatshme sigurie fizike.

Në I.E.V.P. Tropojë nuk kishte më dhomë në të cilën siguroheshin dhe trajtoheshin personat e arrestuar dhe të ndaluar nga Komisariati i Policisë Tropojë. Kjo dhomë tashti ishte përshtatur dhe kthyer në një dhomë takimit të dënuarve/paraburgosurve me avokatët apo prokurorët.

## **3. Kushtet materiale**

Kushtet materiale në I.E.V.P. Tropojë u gjetën të përmirësuara nga inspektimi i mëparshëm. Ndërtesa e këtij institucioni përbëhej nga dy kate dhe një kat pjesërisht nëntokë vetëm nga njëri krah. Ky i fundit ka dalje të drejtpërdrejtë mbi tokë (nga krahu tjetër), jashtë godinës pasi vetë ndërtesa është e pozicionuar mbi një pjesë kodrinore. Në këtë kat, pjesërisht nëntokë, ndodhej kuzhina e institucionit. Problematikat e lagështirës në perimetrin e godinës kishin gjetur zgjidhje optimale falë ndërhyrjes dhe riparimeve të ulluqeve dhe dranazhimit dhe riparimit të kanaleve ujëmbledhës të cilët kishin eliminuar ndjeshëm lagështirën në objekt.

Në katin e parë të ndërtesës gjendej dhoma e takimit me familjarët dhe avokatin, vendqëndrimi i forcave të ndërhyrjes së shpejtë, një ambient për magazine dhe regjimi i brendshëm.

Në hyrje të regjimit të brendshëm ndodhej infermeria. Në korridor ishte vendosur kabina e telefonit. Të drejtat dhe detyrat e të paraburgosurve ishin të afishuara po aty.

Në regjimin e brendshëm, gjendeshin 6 dhoma për 4 persona dhe 2 dhoma për 2 persona, ambientet e dushit (nga dy poste të ndara që siguronin privatësinë) si dhe ambienti për ajrim të jashtëm. Nga vizita në dhomat e paraburgimit u vu re se ato ishin kryesisht të pastra dhe të lyera, por nuk e respektonin hapësirën jetike, gjë e cila krijonte probleme për ajrosjen.

Nga inspektimi rezultoi se ambienti i tualetit/dusheve ishte rikonstruktuar dhe pajisur me nje të reja hidrosanitare. Kalendari i dusheve ndodhej i afishuar, por nga pohimet e të paraburgosurve/ dënuarve u konstatua se nuk kishte pengesa dhe kufizime në bërjen e dusheve dhe përtej parashikimeve të planifikuara. Çarçafët ndërroheshin një herë në 15 ditë, ndërsa ambienti i dusheve shfrytëzohej nga vetë të paraburgosurit/ dënuarit, për larjen e rrobave personale.

Hapësira e ajrimit ishte e vogël për organizimin e lojërave përtej atyre të tavolinës, pasi edhe kjo hapësirë ishte e ndarë në dy poste të veçuara për të paraburgosurit dhe të dënuarit. U konstatua që kishte një plan afat-shkurtër për zgjerimin e ambienteve të ajrimit duke lidhur këto ambiente me fushën e kalçetos dhe krijimin e hapsirave të reja të përshtatura për zgjerimin e ambienteve të ajrimit për të dënuarit/paraburgosurit.

Gjatë vizitës në kuzhinën e I.E.V.P.-së, u konstatuan kushte të përshtatshme higjieno-sanitare dhe pajisjet e domosdoshme për gatimin dhe mirëmbajtjen e ushqimeve. Në të punonin dy kuzhinierë. Menyja ditore gjendej e afishuar dhe gramaturat dhe kaloritë ishin brenda standardeve. Librezat shëndetësore gjendeshin po aty. Kampionët e ushqimeve të gatuar një ditë më parë ruheshin në kushte frigoriferike. Gjithashtu u konstatua fakti se ambientet e kuzhinës ishin pajisur me mjete të reja dhe të përshtatshme gatimi.

#### **4. Regjimi dhe aktivitetet**

Orari i veprimeve ishte i afishuar. Në lidhje me ajrimin, rezultoi se të paraburgosurit/ dënuarit qëndronin më vete 4-5 orë në ajrim, 2-3 orë paradite dhe 2 orë pasdite. Në ambientet e ajrimit zhvilloheshin lojëra si shah, domino, letra etj. Edhe hapësira për ecje ishte mjaft e kufizuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua fakti se Drejtoria e I.E.V.P. Tropojë i është drejtuar Drejtorisë Përgjithshme Bujëqesë Tiranë me shkresën me nr. 763 prot. datë 04.06.2018 lidhur me miratimin e ndërtimit të një minifushe, me qëllim që të burgosurit të kenë një hapësirë më të madhe dhe mund të organizojnë aktivitete e veprimtari me karakter edukativ, artistik, kulturor e sportiv. Lidhur me këtë kërkesë administrata e I.E.V.P. Tropojë kishte hartuar një projekt specifik të shoqëruar me parashikime buxhetore dhe ishte në pritje të miratimit të tij nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Bujëqesë.

Për shkak të mungesës së dhomës së aktiviteteve, nuk ofroheshin mjaftueshëm kurse arsimore e formimi profesional, por sipas rastit në korridor ose në ambientet e ajrimit mundësohej trajtimi i temave të ndryshme dhe recensionet e librave. Me gjithë kufizimet infrastrukture, specialisti i sektorit psiko-social punonte në mënyrë aktive që të mundësonte aktivitetet të ndryshme social- kulturore.

Në institucion nuk kishte persona të kategorizuar me probleme të shëndeti mendor, e megjithatë specialisti i kujdesit social i kontaktonte dhe punonte çdo ditë me për të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale rezultoi se ato ishin të plotësuar mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të paraburgosurit, vlerësimet e sjelljes dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

## 5. Shërbimet shëndetësore

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga 1 mjek me kohë të pjessme që ofronte 90 orë shërbime në muaj dhe 3 ndihmësmjekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se të gjithë librat/regjistrat ishin të plotësuar në mënyrë të rregullt dhe kartelat mjekësore mbaheshin në dollap të kyçura.

Dhoma e mjekut, infermierisë dhe farmacia ishin të rregullta dhe të mirëmbajtura. Infermiera gjendej brenda në regjim dhe ishte e rregullt, e pajisur me krevat vizitash, aparat tensioni, mjekime të urgjencës dhe terapinë ditore.

Furnizimi me medikamente kryhej me kërkesë nga D. P. Burgjeve. Mjekimet, përfshirë ato personale të sjella nga familjarët, administroheshin nga ndihmës mjekët e turnit.

Autoambulanca në këtë institucion mungonte prej kohësh, por lëvizjet për në Qendrën Spitalore Tiranë mundësoheshin me automjetin e Komisarariatit të Policisë Tropojë. Shërbimi stomatologjik mundësohej jashtë institucionit nga ofrues privatë, me rekomandimin e mjekut, dhe mbulohej financiarisht nga familjarët.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar ku parashikohet midis të tjerash se: “Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

*b) të paraqesë rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”.*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave për miratimin dhe materializimin e planit për zgjerimin e ambienteve të ajrimit për të dënuarit /paraburgosurit ne I.E.V.P. Tropojë.
2. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve të përshtatshme për ofrimin e kurseve arsimore e atyre të formimit profesional.

3. Marrjen e masave për mundësimin brenda skemës së sigurisë të hapjes së dyerve për të lehtësuar ajrosjen në ambientet e brendshme gjatë stinës së dimrit.
4. Marrjen e masave për mbajtjen e arkës në institucion për të mundësuar blerjet nga ana e të paraburgosurve dhe të dënuarve ose pajisjen e tyre me karta bankare.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) Tropojë, sipas kontratës tre palëshe ISKSH, depo farmaceutike.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj.*

**K O M I S I O N E R E**

**Ermonela XHAFA**